

E ENJTE DATA 23 SHKURT 2023

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë që na ndiqni sot në këtë seancë,

Projekti që kemi përpara përfundon një nga proceset më të rëndësishme, të lëna në mes nga ata të cilët përбетohen për të drejtën e pronës, nga ata të cilët sot janë gati të vazhdojnë t'u bien tavolinave, por vetëm të drejtën nuk e çojnë te pronari. Në fakt, janë të shqetësuar për një pronar: janë shqetësuar për pronarin e partisë së tyre, por jo për ata ish-bujq, për ata ish-agronomë të ndërmarrjeve bujqësore, pjesëtarë të ndërmarrjeve bujqësore, veterinerë dhe shumë profesionistë të nderuar, të cilët kanë pasur mundësinë që, në zbatim të ligjit, të privatizojnë objekte të ndërmarrjeve bujqësore, ku ata kanë punuar dhe nuk kanë pasur mundësi t'i regjistrojnë. Sot ne u japim mundësinë që të përfundojnë një kalvar 25-vjeçar, i cili ka nisur me një vendim të Këshillit të Ministrave të vitit '98 dhe janë endur për 25 vjet, derisa ne arritëm të ndërtonim një agjenci moderne për kadastrën.

Sot, pasi kemi përfunduar edhe bazën ligjore përkatëse, sjellim këto ndryshime dhe më në fund ata qytetarë, të cilët kanë lidhur një kontratë, por nuk e kanë lidhur atë në formën e ligjit para noterit; ata qytetarë të cilët kanë bërë një pjesë të pagesës, por nuk kanë mundur ta përfundojnë atë; ata qytetarë, të cilët nuk kanë kryer asnjë nga këto, por kualifikohen si përfitues të objekteve, në të cilat ata kanë punuar dhe kanë pasur mundësi, pra ligji u jepte mundësi t'i privatizonin, t'i drejtohen Ministrisë së Bujqësisë, si agjencia përkatëse për zbatimin e këtij ligji, dhe drejtorive të ekstensionit bujqësor, që ta përfundojnë këtë proces, të çojnë dosjen e plotë që ata kanë, për të përfunduar procesin e privatizimit. Këtë gjë bën ky projekt sot. Ndaj, i ftoj kolegët ta mbyllin atë, sepse ekskursioni jashtë ka përfunduar. Ju mund ta përfundoni rënien e daulles së improvizuar aty. Le ta çojmë pronën tek i zoti, që edhe këtë historinë e të përбетuarve për pronën e shqiptarëve, por që merakun e kanë te prona e pronarit dhe që partinë e nderuar të opozitës e kthyen në një plaçkë lufte, ta mbyllim dhe t'i japin fund kësaj gjëje. Ju ftoj ta votoni.